



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
Ministarstvo Obrazovanja, Nauke, Tehnologije i Inovacije -- Ministry of Education, Science,
Technology and Innovation

Datë: 26-09-2023
Nr. 5/3207

Komisioni për licencimin e BPrAL/ kolegjeve private i Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, në mbështetje të dispozitave ligjore nga neni 11 paragrafi 3 dhe 4, dhe neni 14 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës nr. 04/L-037 në bazë të neneve 5, 6, 7, dhe 10 të Udhëzimit administrativ nr. 25/2012 për Licencimin e Bartësve Privat të Arsimit të Lartë, shqyrtoi kërkesën nr. 5 me nr. protokoll 3207 të datës 01.09.2023, të parashtruar nga BPrAL - kolegji "BIZNESI" për licencimin e programit sipas vendimit me ref.1021/23 i datës 26.07.2023 dhe mori këtë :

V E N D I M

1. Licencohet Bartësi Privat i Arsimit të Lartë - kolegji "BIZNESI" për periudhën trevjeçare (1 tetor 2023 deri me 30 shtator 2026).
2. Licencohet programi; Shkenca Kompjuterike BSc 180 ECTS (A) me kuotën maksimumi 80 studentë për vit akademik i akredituar nga AKA sipas vendimit me ref.1021/23 i datës 26.07.2023 .
3. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m

Në mbështetje të dispozitave ligjore të cekura më lartë, komisioni për licencim dhe rilicencim të BPrAL/ kolegjeve private i Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, pas shqyrtimit të kërkesës nr.5 protokoll 3207 të datës 01.09.2023 të parashtruar nga kolegji "BIZNESI", vlerëson se parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kushtet dhe kriteret ligjore për licencim.

Licenca e këtij institucioni privat të arsimit të lartë, zgjat tri vite akademike (01.09.2023 deri me 30 shtator 2026) sipas vendimit ref.1021/23 i datës 26.07.2023 të Agjencionit të Kosovës për Akreditim.

Komisioni për licencim i MASHTI, duke marrë parasysh faktet e këtij institucioni të paraqitura në dokumentacionin e kompletuar ligjërisht për aplikim, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi te Sekretari i përgjithshëm i MASHTI-t.

Vendimi u dërgohet:

1. Parashtruesit të kërkesës;
2. Komisionit për licencim;
3. Sekretarit të përgjithshëm;
4. DALSHT;
5. Inspektoratit të Arsimit;
6. Arkivit.

Kryetar i Komisionit



Burim Gashi